

VENDIM
Nr. 276, datë 13.4.2016

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT PËR MEDALJET NË FORCAT E
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 9/2015, “Për medaljet në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masa e shpërblimit për medaljet që jepen sipas ligjit nr. 9/2015, “Për medaljet në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të jetë si më poshtë vijon:

a) Për medaljet që jep ministri i Mbrojtjes:

- | | |
|-------------------------------------|--------------|
| - “Medalja e nderit” | 40 000 lekë; |
| - “Medalja e mirënjohjes” | 30 000 lekë; |
| - Medalja “Në shërbim të atdheut” | 30 000 lekë; |
| - Medalja “Për shërbime të shquara” | 20 000 lekë; |
| - Medalja “Për shërbime të larta” | 20 000 lekë. |

b) Për medaljet që jep shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura:

- | | |
|---|--------------|
| - “Medalja shpëtimtari” | 30 000 lekë; |
| - “Medalja e trimërisë” | 30 000 lekë; |
| - “Medalja e sakrificës” | 20 000 lekë; |
| - “Medalja e karrierës” | 5 000 lekë; |
| - Medalja “Për shërbime të veçanta” | 10 000 lekë; |
| - Medalja “Pjesëmarrje në operacione huma-nitare” | 10 000 lekë; |
| - Medalja “Pjesëmarrje në emergjenca civile” | 10 000 lekë. |

c) Për medaljet që japin komandantët e forcave dhe komandantët e komandave mbështetëse:

- | | |
|---------------------------|--------------|
| - “Medalja e ushtarit” | 10 000 lekë; |
| - “Medalja e pilotit” | 10 000 lekë; |
| - “Medalja e marinarit” | 10 000 lekë; |
| - “Medalja e dijes” | 10 000 lekë; |
| - “Medalja e mbështetjes” | 10 000 lekë; |
| - “Medalja e karrierës” | 5 000 lekë. |

2. Shpërblim për medalje do të marrin vetëm ushtarakët aktivë dhe punonjësit civilë të strukturave organike të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura.

3. Shpërblimet për medaljet sipas pikës 1 të këtij vendimi, jepen, përkatësisht, nga ministri i Mbrojtjes, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, komandanti i forcës dhe komandanti i komandës mbështetëse.

4. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

5. Vendimi nr. 581, datë 10.9.2004, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit për medaljet që i jepen personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

6. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi